



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-8447 /2025

Datë: 26.03 /2025

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën c) dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 pikën 4) dhe Nenin 40 pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës i miratuar në Mars 2010, me kërkesën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të datës: 10.03.2025 me nr. prot-01Nr.510-6969/2025 si dhe me pëlqimin e Drejtorisë për Arsim në Komunën e Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2025 të mbajtur me 21.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për ndërrimin e titullarit pronave si në vijim: parcelat me Nr. P-71010022-00091-0 ZK Dollc, P-71010022-00092-0 ZK Dollc, P-71010022-00093-0 ZK Dollc, P-71010022-00094-0 ZK Dollc, P-71010022-00095-0 ZK Dollc të cilat evidentohen në emër të Pronë Shoqërore, Shkolla Fillore “Dositej Obradoviq” të njëjtat pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi regjistrohen në emer të Komunës së Klinës.
2. Ndërrimi i titullarit të pronës si në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të fillimit të procedurave të ndërtimit të objektit të ri të Qendrës së Mjeksisë Familjare afër Shtëpisë për përkujdejsen e personave të moshuar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkpunim me Drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.
4. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi